

University for Business and Technology in Kosovo

UBT Knowledge Center

Theses and Dissertations

Student Work

Spring 4-2021

ÇËSHTJA E KOSOVËS DREJT STATUSIT FINAL PAKO E AHTISARIT

Qendresa Xhafa

University for Business and Technology - UBT

Follow this and additional works at: <https://knowledgecenter.ubt-uni.net/etd>



Part of the [Political Science Commons](#)

Recommended Citation

Xhafa, Qendresa, "ÇËSHTJA E KOSOVËS DREJT STATUSIT FINAL PAKO E AHTISARIT" (2021). *Theses and Dissertations*. 2575.

<https://knowledgecenter.ubt-uni.net/etd/2575>

This Thesis is brought to you for free and open access by the Student Work at UBT Knowledge Center. It has been accepted for inclusion in Theses and Dissertations by an authorized administrator of UBT Knowledge Center. For more information, please contact knowledge.center@ubt-uni.net.



Kolegji UBT
Fakulteti i Shkencave Politike

ÇËSHTJA E KOSOVËS DREJT STATUSIT FINAL
PAKO E AHTISARIT
Shkalla Bachelor

Qendresa Xhafa

Prill/2021
Prishtinë, Kosovë



Kolegji UBT
Fakulteti i Shkencave Politike

Punim Diplome
Viti akademik 2015-2016

Qendresa Xhafa

**ÇËSHTJA E KOSOVËS DREJT STATUSIT FINAL
PAKO E AHTISARIT**

Mentori: Dr. Ilir Zylfiu

Prill/2021

Ky punim është përpiluar dhe dorëzuar në përmbushjen e kërkesave të
pjeshme për Shkallën Bachelor

Abstrakt

Kur flasim për çështje të zgjidhjes së statutit të shteteve të pavarura në botë shohim modele të ndryshme, në disa raste në histori shohim fitimin e statusit të pavarësisë të shteteve në mënyrë të drejtpërdrejt nga rezultatet e luftërave, në raste të tjera shohim ndërmjetësime të fuqive të mëdha, raste të kompensimeve të ndryshme territoriale ose burimeve të ndryshme natyrore të shteteve. Një nga këto raste e hasim edhe rastin e Kosovës të cilin do të mundohemi të e shtjellojmë gjatë këtij punimi në një analizë të marrëveshjeve të ndryshme duke filluar nga marrëveshja e Kumanovës, rezoluta 1244, vendimi i Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë, si dhe pako e presidentit Ahtisari, Marrëveshja e Rambujesë, Grupet negociatore, Bisedimet e Vjenës, Raporti i z. Kai Aiden. Gjatë këtyre analizave do të shohim këndvështrime dhe pika kyçe të secilit prej dokumenteve të lartcekura lidhur me definimin e statusit të Kosovës.

PËRMBAJTJA

1. HYRJE.....	1
2. SHQYRTIMI I LITERATURËS	2
2.1. Historiku i Kosovës ndër vite	2
2.2. Konferenca e Rambujesë – aspekti juridik dhe ndërkombëtar	3
2.3. NATO dhe çlirimi i Kosovës	5
2.4. Marrëveshja e Kumanovës.....	6
2.5. Rezoluta e Këshillit të Sigurimit – 1244.....	8
2.6. Rezoluta 1244 (1999).....	9
2.7. Periudha tranzitore e Kornizës Kushtetuese	15
2.8. Standardet për Kosovën	16
2.9. Raporti i emisarit të posaçëm të OKB-së z. KAI AIDEN	17
2.10. “Grupi i Kontaktit”	17
2.11. Bisedimet e Vjenës	18
2.12. Pakoja e Ahtisarit.....	18
2.13. Karakteristikat themelore të Pakos së Ahtisaarit	20
2.14. Shpallja e Pavarësisë - Rruga deri më 17 shkurt.....	21
3. DEKLARIMI I PROBLEMIT	23
4. METODOLOGJIA.....	24
5. PËRFUNDIMET	25
6. BIBLOGRAFIA DHE REFERNCAT:.....	26

1. HYRJE

Qëllimi i punimit të kësaj teme është një analizë e procsit të shtetformimit të Kosovës qysh nga kohërat historike e deri pas shpalljes së Pavarsisë, sfidat dhe mundimet që kishte populli i Kosovës ndër vite.

Në këtë kapitull do të bëhet trajtimi i materialit në bazë kryesore duke filluar nga Historia, proceset negociuese që nga Konferenca e Rambujesë, Marrveshja e Komunaovës, Marrveshja e Brukselit dhe proceset e tjera negociatore, poashtu procesi i dialogut, standartet para statusist të Kosovës, procesi i tranzicionit, Pakoja e Ahtisarit dhe shpallja e Pavarsisë së Kosovës.

Nga të gjitha proceset më së shumti jam fokusuar në Pakon e Ahtisarit pasi që shihet një ndër proceset më vendimarrëse për zgjidhjen statusit të Kosovës.

Në këtë punim seminarik do të shtjellohet edhe metodologjia e punimit dhe në fund të punimit do të jepen përfundimet e punimit.

2. SHQYRTIMI I LITERATURËS

Në këtë kapitull është bërë trajtimi i shumë dokumenteve dhe burimeve me qëllim të përpunimit dhe nxerrjes së përfundimeve sa më të thukta me qëllim të shërbimit të hulumtimit të bërë.

2.1. Historiku i Kosovës ndër vite

Territori i sotshëm i Republikës së Kosovës, ka një histori të gjatë të dyndjeve dhe pushtimeve të ndryshme në periudha të ndryshme kohore, nëse e shikojmë faktet e para të popullimit të kësaj zone hasim qysh nga koha e paleolitit mbi 100 mijë vjet më parë dhe në atë kohë Kosova njihej si Dardani, emërtim ky i përdorur nga lashtësia e deri në shekullin XIX. Territori i lashtë i Dardanisë përfshinte qytete kryesore si Damastionin, Nishin, Shkupin, si dhe Ulpianën. Dardania u pushtua për shumë herë nga perandori të ndryshme, nga ajo romake, bizantine, bullgare dhe së fundmi perandoria serbe, por asnjëherë nuk qe e mundur çrrënjësja e gjurmëve shqiptare në këto treva. Gjatë periudhës së pavarësisë nga perandoria osmane, Kosova vijoi të luajë rol të rëndësishëm në lëvizjen kombëtare shqiptare, sidomos gjatë Kryengritjes së Përgjithshme të vitit 1912, kur luftëtarët shqiptarë çliruan pothuajse tërë vilajetin e Kosovës dhe marshuan ngadhënjimtarë në kryeqytetin e atëhershëm, Shkupin. Më 28 nëntor 1912, në Kuvendin Kombëtar të Vlorës që shpalli pavarësinë e Shqipërisë, delegatët e Kosovës votuan pro-pavarësisë duke e njohur Kosovën si pjesë të tërësisë tokësore shqiptare. Mirëpo fuqitë e mëdha nuk e njohën Shqipërinë në territorin e asaj që njihet si Shqipëri Etnike, por i ndanë disa territore duke përfshirë edhe Kosovën që ju aneksua Jugosllavisë. Përgjatë periudhës pas 1912 me qindra mijëra shqiptar u shpërngulen nga territoret e Shqipërisë së madhe dhe një pjesë e tyre mbeti në Kosovë dhe Ballkan, ndërsa një pjesë bukur e madhe u shpronësuan dhe u dërguan në Turqi. Në vitet 1970, u themeluan Universiteti i Prishtinës, Akademia e Arteve dhe Shkencave, si dhe radiotelevizioni i Kosovës, institucione këto që i çelën rrugë ngritjes intelektuale e kulturore dhe zhvillim të përgjithshëm të popullsisë shqiptare. (core.ac.uk/display/143966928)

Më 1987, nacionalistët serbë me udhëheqësin e ri Slobodan Millosheviq organizuan në Fushë Kosovë një komplot kundër autonomisë së Kosovës dhe popullsisë shqiptare. Agjentët serbë

fajësuan shqiptarët për gjoja jetën e vështirë të serbëve në Kosovë dhe sulme të vazhdueshme ndaj pranisë së tyre në këtë trevë. Në kushtet e pushtimit serb, më 2 korrik 1990, deputetët e Kuvendit të KSA të Kosovës, të ndaluar të hyjnë në godinën zyrtare, nxorën para dyerve të saj Deklaratën e Pavarësisë, duke e shpallur Kosovën republikë anëtare të federatës jugosllave. Më 7 shtator të po këtij viti, u miratua në Kaçanik Kushtetuta e Republikës, e para kushtetutë demokratike e shtetit kosovar. Më tetor 1991, u zhvillua referendumi mbarë popullor që zyrtarisht e shpalli Kosovën të pavarur e sovranë, ndërsa Ibrahim Rugova u zgjodh njëzëri Kryetar i Republikës në zgjedhjet e vitit pasues dhe organizoi rezistencën paqësore kundër pushtimit serb. Gjendja e popullsisë shqiptare në Kosovë gjatë viteve '90 mbeti jashtëzakonisht e vështirë. Gati të gjithë të punësuarit në sektorin publik u dëbuan, u mbyll universiteti dhe shkollat e mesme në gjuhën shqipe, shtypi dhe radiotelevizioni. Protestat studentore, ndonëse ishin ndërprerë në fillim të '90-, u rinisën më 1 tetor 1997 të organizuara nga studentët vazhduan edhe gjatë vitit 1998, ndërsa policia serbe brutalisht iu kundërpërgjigj kërkesave të shqiptarëve për liri (*Historia e Kosovës nga Mbretëria Dardane deri në dyndjet e popujve Slav*).

Ishin vitet 90-ta kur shqiptarët në përgjithësi filluan të organizohen për ngritjen e një force ushtarake për mbrojtjen e Kosovës që më vonë u njofto si Ushtria Çlirimtare e Kosovës – UÇK. Në këtë aspekt ndihmuan edhe trazirat e ndodhura në Shqipëri, pasi qe u dha një mundësi e mirë për furnizim me armë trupave të UÇK-së. Ngjarje tjetër që ndikoj në rritjen e radhëve të vullnetarëve si ushtar ishte flijimi i familjes Jashari, si dhe masakrat e ndryshme, si ajo Recakut, Rahovecit, Gjakovës, Mejes etj.

Në shkurt 1999 në Rambouillet të Francës, u organizuan bisedimet shqiptaro-serbe për t'i dhënë fund luftës. Pala shqiptare nënshkroi marrëveshjen e propozuar nga ndërmjetësuesit ndërkombëtar, kurse serbët refuzuan të nënshkruanin. Në përfundim të luftës, Kosova numëroi gati 15.000 të vrarë, 5.000 të zhdukur dhe dëme të rënda materiale.

2.2. Konferenca e Rambujesë – aspekti juridik dhe ndërkombëtar

Lufta dhe gjenocidi i shkaktuar në Kosovë nga forcat serbe detyroi edhe një herë bashkësinë ndërkombëtare të merren me qështjen e Kosovës. Me këtë rast u mbajtën dy konferenca ndërkombëtare ajo e Rambujesë (6 – 23 shkurt 1999) dhe konferenca e Parisit (15-18 mars 1999).

Në atë kohë ishte shfaqur rreziku që lufta e forcave serbe të tejkalonte kufijtë e Kosovës dhe kështu të destabilizonte sigurinë ndërkombëtare. Këto konferenca ishin organizuar me qëllim të vendosjes së një statusi kalimtar të Kosovës dhe tejkalimi i krizës që mbretëronte si dhe Kosova të vendosej nën protektoratin e NATO-së.

Grupi i kontaktit ishte një trupë që e organizoi konferencën e cila kryesohej nga tre bashkë kryesues: Kristofer Hill nga SHBA, Wolfgang Petriç nga Këshilli i Evropës si dhe Boris Majorski nga Federata Ruse. Pjesëmarrës kryesor në këtë konferencë ishin pala kosovare e përfaqësuar nga subjektet politike dhe përfaqësues të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe ekspert të pavarur, dhe pala serbe e përfaqësuar nga zyrtar politik të Serbisë.

Negociatat në këtë konferencë filluan dhe u zhvilluan në bazë të një projekt marrëveshje të përgatitur nga grupi i kontaktit, për paqe dhe vetëqeverisje të Kosovës. Kjo projekt marrëveshje parashihte arritjen e një zgjidhje për krizën në Kosovë, të vendosej Kosova nën mbikëqyrjen e NATO si dhe të fillohet përcaktimi i një statusi final të Kosovës për vetëqeverisje.

Një e veçante e kësaj e konference ishte qasja e palës shqiptare që refuzonte të takohej me palën serbe ani pse pala shqiptare ishte mjaft bashkëpunues dhe konstruktive me faktorin ndërkombëtar, ndërsa në anën tjetër pala serbe më shumë shfaqej si një palë jo serioze dhe destruktive për arritjen e marrëveshjes dhe palë kundërshtuese që Kosova të largohej nga administrimi i Serbisë. (*Blerim Shala "Vitet e Kosovës 1998-1999", 2001*)

Rol të veçante në këtë konferencë kishin edhe ekspertët amerikan të cilët hartuan të gjitha draftet e konferencës. Siç u cek edhe më lart kjo konferencë u mbajt në dy pjesë, atë të parën në Rambuje dhe të dytën në Paris, në fund të periudhës së parë delegacioni i Kosovës mori një mbështetje të fort nga zonja Medllin Olbrajt e cila në atë kohë kishte rolin e sekretares së jashtme të SHBA-së.

Pjesa e dytë e konferencës ishte pjesë më ceremoniale e cila u organizua në Paris të Francës dhe ishte momenti i nënshkrimit të marrëveshjes, gjë që pala kosovare u pajtua të e nënshkruante këtë marrëveshje ndërsa pala serbe ishte si gjithmonë refuzuese deri në fund duke refuzuar të nënshkruaj këtë marrëveshje edhe pse kjo marrëveshje ishte nënshkruar si garanci edhe nga pala ndërkombëtare. Kjo marrëveshje kishte tetë kapituj kryesor, ndër pikat kryesore të kësaj marrëveshje ishte mundësia e mbajtjes së referendumit nga populli i Kosovës me qëllim të zgjidhjes së statusit final të Kosovës gjë që u garantua edhe nga deponimi i garancinë me shkrim

nga zonja Ollbrajt, si dhe një klauzolë e veçantë e kërkuar nga pala kosovare në të cilën përveç tjerash thuhej se pas tri viteve do të duhet të organizohej një mbledhje e organizmave ndërkombëtar me qëllim të zgjidhjes së statusit final të Kosovës (*Arsim Bajrami: Historia e Konstucionalizimit Shqiptar 1912-2012.*)

Nënshkrimi i kësaj marrëveshje nga pala kosovare dhe refuzimi nga pala serbe hapi rrugë për fillimin e fushatës bombarduese të NATO-së kundër Serbisë.

Në aspektin juridik marrëveshja e Rambujesë cilësohet si e pa qëndrueshme për shkak se jo të gjitha palët kanë nënshkruar këtë marrëveshje dhe si e tillë është e pa arritur në mes të palëve. Rezoluta që do të shtjellojmë më vonë në tekst e njohur si rezoluta 1244 i referohej kësaj marrëveshje gjë që ishte juridikisht dhe politikisht e paqëndrueshme.

Marrëveshja e Rambujesë ishte e njohur me titullin “Marrëveshja e përkohshme për paqe dhe vetëqeverisje në Kosovë”

2.3. NATO dhe çlirimi i Kosovës

Mos nënshkrimi i marrëveshjes së Rambujesë nga pala serbe solli dështimin e kësaj marrëveshje dhe njëkohësisht fillimin e fushatës 78 ditëshe të bombardimeve nga NATO. Bombardimet filluan me 24 mars 1999 dhe goditën caqet e ndryshme ushtarake dhe strategjike të shtetit serb, gjë që ngjalli mjaft nervozizëm tek udhëheqja serbe dhe vet Presidenti i Serbisë Milloshoviç u dha urdhër për një luftë dhe spastrim të ashpër në Kosovë, gjatë kësaj periudhe u shfaq një terror i pa shembull në Kosovë duke u zhvilluar persekutime, dhunime, vrasje, masakra, e dëmtime të pasurive të popullit të Kosovës. Bombardimet e zhvilluara nga ajri dhe lufta e UÇK-së nga toka mundësuan që të bëhej çlirimi i territorit të Kosovës nga okupatori serb, dhe largimin e të gjitha forcave jugosllave nga Kosova së bashku me pushtetin administrativ. (*www.hrw.org*)

Fushata e bombardimeve të NATO-së kishte veçantinë e vet pasi që kësaj here filloj pa mandatin formal të Këshillit të Sigurimit, si një fushatë e një fuqie ushtarake ndërkombëtare kundër një shteti të pavarur. Qëllimi i kësaj fushate ishte të parandalohen vrasjet dhe persekutimet e popullit të Kosovës nga ana e Serbisë, gjë që me fillimin e kësaj fushate u dha një reagim krejt i kundërt nga ai që ishte planifikuar. Pala serbe intensifikoj aksionet e tyre duke vrarë shumë shqiptar civil të pa

fajshëm dhe duke dëbuar mbi një milion shqiptar nga Kosova drejt vendeve të rajonit dhe Evropës, duke shkaktuar një krizë humanitare dhe ngritur rrezikun për destabilizim të vendeve pritëse për shkak të numrit të madh të refugjatëve. Vazhdimi i operacioneve të forcave serbe e detyroj NATO-në që të zbarkoj trupa toksore në shtetet për rreth Kosovës duke shkaktuar frikë tek pala serbe. (<https://www.dw.com/sq/bombardimet-q%C3%AB-i-dhan%C3%AB-fund-vuajtjes/a-17517608>)

Nëse shohim në aspektin juridik fushatën e bombardimeve të NATO-së kundër Serbisë mund të themi që ishte një fushatë legjitime për faktin se kjo fushatë është filluar me qëllim që të mbrohen të drejtat e njeriut gjë që janë më të vlefshme në raport me sovranitetin e një shteti. Pikërisht ky fakt e bënë ligjërisht legjitim këtë fushatë qoftë edhe pa mandatin e OKB-së.

Kjo fushatë hapi polemika të shumta të legjitimitetit në mes të ekspertëve të ndryshëm ndërkombëtar, disa nga ekspertët prononcoheshin se kjo ishte një fushatë jo legjitime ndërsa pala tjetër e mbronte këtë fushatë duke ju referuar bazës juridike të kaptinës së shtatë të Kartës së OKB-së. Përfundimi i periudhës së komunizmit solli edhe doktrinën që shtetet nuk kanë të drejt të bëjnë persekutimin e qytetarëve të vet dhe të drejtat e njeriut qëndrojnë mbi sovranitetin e shteteve.

Lufta e NATO-së dhe UÇK-së e detyroj Serbinë që të pranoj humbjen e luftës në Kosovë dhe të shpall kapitullimin, si dhe të nënshkruaj marrëveshjen ushtarako-teknike e njohur si “Marrëveshja e Kumanovës” (*Arsim Bajrami: Historia e Konstucionalizimit Shqiptar 1912-2012 Fq. 227*)

2.4. Marrëveshja e Kumanovës

Në verën e vitit 1999 po i vinte fundi luftës në Kosovë, kështu që më 10 qershor 1999 u arrit marrëveshja e Kumanovës për tërheqjen e forcave serbe dhe hyrjen e forcave të NATO-s në Kosovë. Kjo marrëveshje e njohur ndryshe si marrëveshja ushtarako-teknike në Kumanovë (*Marrëveshja e Kumanovës 1999*) i dha fund dhunës serbe në Kosovë si një parakusht për ndaljen e bombardimeve të NATO-s mbi caqet strategjike serbe. Kjo marrëveshje i dha fund po ashtu prezencës së forcave ushtarake dhe policore serbe në Kosovë. Kjo marrëveshje u nënshkrua në mes të NATO me përfaqësueses Komandantin e parë të KFOR-it z. Michael Jackson dhe gjeneralin serb Nebojsa Pvkoviq si përfaqësues i ushtrisë së Serbisë. Kjo marrëveshje u nënshkrua me 9 qershor 1999 në Kumanovë të Maqedonisë.

Kjo marrëveshje përcakton modalitete tekniko-ushtarake të tërheqjes së forcave serbe nga territori i Kosovës, dinamikën e tërheqjes dhe hyrjen e forcës ndërkombëtare të sigurisë. Marrëveshja përmban gjithsej 6 nene dhe dy shtesa (*Marrëveshja e Kumanovës 1999*)

Marrëveshja është arritur pas fushatës së bombardimeve të NATO-s mbi caqet serbe, e cila ka zgjatur për 78 ditë me radhë, si dhe pas përpjekjeve diplomatike për t'i dhënë fund luftës në Kosovë, gjatë të cilës mbi 15 mijë njerëz janë vrarë ose zhdukur dhe mbi një milion janë zhvendosur. Shkatërrimet materiale po ashtu kanë qenë masive. Në bazë të kësaj marrëveshjeje Serbia detyrohej që të tërheq të gjithë trupat e veta nga Kosova, përfshirë këtu të gjitha llojet e armatosura si armatën e rregullt dhe forcat e marinës, civilë të armatosur, paramilitarë, forcat ajrore, garda kombëtare, policia kufitare, rezervistët, policia ushtarake, shërbimet informative, MUP-it, policia lokale, speciale, antirebeliste, antiterroriste dhe çdo grup i përcaktuar kështu nga KFOR-i. (*KCSS, Context Analyzes of SSR in Kosovo, Fq 5*)

Në një pikë tjetër u përcaktua një zonë sigurie ajrore 25 kilometra përtej kufirit të Kosovës, e ndërsa në pikën që kishte të bënte me zonën kufitare u përcaktua një zonë prej 5 kilometrash përtej kufirit me RFJ-në që nuk guxonte të vendosen armatimet e rënda dhe ushtria, përveç ushtarët kufitarë.

12 Qershori 1999 shënohet si dita e parë e zbarkimit të trupave të këmbësorisë së NATO-së në Kosovë si dhe largimin e forcave serbe nga Kosova. Dy ditë më herët Sekretari i përgjithshëm i NATO-së dha urdhrin për ndërprerjen e fushatës bombarduese si dhe Këshilli i Sigurimit miratoi një rezolutë për zbarkimin e forcave të KFOR-it që më vonë do të njihej si rezoluta 1244. Në bazë të kësaj rezolute një forcë ushtarake e përbërë nga 37,200 Ushtarë nga 36 shtete të botës do të garantonte paqen në Kosovë. Kjo forcë ishte e ndarë në 5 regjione që i përkisnin forcave Amerikane, Angleze, Franceze, Gjermane, dhe Italiane. Përveç forcave të KFOR-it në Kosovën e pasluftës u instalua edhe misioni i administratës së Kombeve të Bashkuara, e njohur ndryshe si UNMIK, mision ky që qëndroj aktiv deri në shpalljen e Pavarësisë së Kosovës.

Një pikë e rëndësishme dhe shpesh e shumë përfolur e marrëveshjes së Kumanovës ishte edhe shpërbërja e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe shndërrimi i saj në Trupat Mbrojtëse të Kosovës, një forcë që nuk kishte karakter ushtarak dhe ishte e armatosur me armatim të lehtë që më vonë do të shndërrohej në Forcën e Sigurisë së Kosovës dhe krejt në fund si Ushtri e Kosovës.

Me 17 Shkurt 2008, Kosova shpalli pavarësinë, ditë kjo e cila u përcoll nga shumë media të huaja dhe vendore si dhe me emocione të mëdha si një nga arritjet më të mëdha të shqiptarëve që nga shpallja e pavarësisë së Shqipërisë me 1912.

2.5. Rezoluta e Këshillit të Sigurimit – 1244

Një rezolutë e shumë përfolur dhe me standarde të dyfishta për statusin e Kosovës ishte Rezoluta e Këshillit të Sigurimit e njohur ndryshe si Rezoluta 1244. Kjo rezolutë formalisht e mbajti Kosovën nën sovranitetin e Jugosllavisë, por nën administrim ndërkombëtar të Kombeve të Bashkuara. Në ditët e para të kësaj rezolute ndodhën dy ngjarje interesante: forca ruse hynë në trevën e Kosovës për të shpëtuar makinerinë serbe të ndodhur në Aeroportin e Prishtinës. Një ditë më pas, Ushtria Çlirimtare hyri në kryeqytet, ndërsa trupat serbe u tërhoqën duke i lëshuar vendin forcave aleate. U organizua forca paqeruajtëse e KFOR-it, ku për një kohë bënë pjesë edhe trupat ruse.

Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) filloi punën për vendosjen e sundimit të ligjit dhe për themelimin e institucioneve vetëqeverisëse. Më 2001, UNMIK-u nën dokumentin e Kornizës Kushtetuese organizoi zgjedhjet e para të lira në historinë e Kosovës. Më 2002, Ibrahim Rugova u zgjodh Kryetar i Kosovës, ndërsa Bajram Rexhepi kryeministër i parë i pasluftës. Megjithatë, kompetencat kryesore mbetën në duart të UNMIK-ut (unmik.unmissions.org/sq/rezoluta-1244-e-kombeve-t%C3%AB-bashkuara).

Një nga çështjet më të diskutueshme të kohës ishte ndarja e qytetit të Mitrovicës, e cila mbeti si pikë e nxehtë për shumë vite, gjë që shkaktoj pakënaqësi të shumta tek populli shqiptar duke pasur protesta të shumta të dhunshme duke përfshirë edhe ato të marsit 2004 të cilat ishin mjaft të dëmshme për imazhin e Kosovës në aspektin ndërkombëtar, pasi që gjatë këtyre protestave u shkatërruan shumë objekte të kultit fetar katolik dhe ortodoks, si dhe objekte të trashëgimisë kulturore, gjë që në aspektin ndërkombëtar u panë si një dobësi e shqiptarëve ani pse qeveri e Kosovës e mori përsipër renovimin e të gjitha dëmeve të bëra gjatë protestave.

Njëherit kjo rezolutë kishte shënuar edhe fundin e luftës së UÇK-së dhe fushatës së bombardimeve të NATO-së si dhe mundësoj kthimin e popullatës shqiptare të shpërngulur me dhunë nga trojet e tyre.

Nxirrja e kësaj rezolute nga OKB ishte një ndërmarrje mjaft komplekse e OKB-së dhe e para e këtij lloji. Komplexiteti i saj qëndronte në faktin se ishte operacioni i parë i vendosur në një shtet si fazë e tranzicionit të pasluftës dhe e përbërë nga një administratë ndërkombëtare e ngërthyer me përfaqësim ushtarak dhe në kombinim me një administratë lokale me qëllim të zgjidhjes së statusit final të një vendi.

Si rezolutë ishte marr më shumë me pasojat e shkaktuara nga lufta se sa me burimin e konfliktit. Në anën tjetër kjo rezolutë kishte një rol balancues duke mos njohur okupimin institucional nga ana e Serbisë në vitin 1990 po ashtu as referendumin e popullit të Kosovës për pavarësi, si dhe paraqiste vetëqeverisjen e Kosovës nga Misioni i përkohshëm i kombeve të bashkuara në Kosovës – UNMIK në tri sfera: legjislative, ekzekutive dhe gjyqësore (*S/RES/1244 1999 10 Qershor 1999 - UN Rezoluta e kombeve të bashkuara 1244*).

2.6. Rezoluta 1244 (1999)

Kjo rezolutë është e miratuar nga Këshilli i Sigurimit në mbledhjen e 4011 me 10 Qershor 1999, dhe duke pasur parasysh të gjitha rrethanat e ndodhura në territorin e Kosovës duke filluar nga tërësia territoriale e Republikës Federative të Jugosllavisë, dhunën e shkaktuar në Kosovë gjatë periudhës së luftës, shpërnguljen e refugjatëve, krimet dhe vrasjet gjatë luftës shtetet zotohen se do të veprojnë në bazë të kësaj rezolute me qëllim të zgjidhjes së konfliktit dhe krizës humanitare të shkaktuar në Kosovë si pasojë e luftës së ndodhur nga vitet e më përparshme. Po ashtu duke u bazuar në rezolutat e më herëshme të nxerrura për qështjen e Kosovës por të cilat nuk ishin të zbatuara plotësisht, në bazë të kësaj rezolute vendoset se duhet garantuar sigurinë e personelit ndërkombëtar dhe zbatimin nga të gjitha palët e përfshira, po ashtu vendoset dhe kërkohet në veçanti që RFJ t'i japë fund menjëherë dhe në mënyrë të verifikueseje dhunës dhe represionit në Kosovë, dhe të fillojë tërheqjen e plotë dhe të verifikueseje sipas fazave të forcave ushtarake, policore dhe paramilitare në bazë të një orari të caktuar, me të cilin do të sinkronizohet vendosja e pranisë ndërkombëtare të sigurisë në Kosovë.

Një pikë tjetër që parashihet në bazë të kësaj rezolute është dërgimi në Kosovë të një trupe civile ndërkombëtare me qëllim të garantimit të funksionimit të shtetit ligjor dhe garantimit të shtetit ligjorë po ashtu pritet që kjo të bëhet në pajtim me RFJ-në

Në bazë të kësaj rezolute vendoset që prania ndërkombëtare e sigurisë që ishte vendosur në Kosovë të i kishte përgjegjësitë e veta si ë vijim:

a) Pengimin e ripërtëritjes së armiqësive, ruajtjen dhe, atje ku është e nevojshme imponimin e armëpushimit, si dhe sigurimin e tërheqjes dhe parandalimin e kthimit në Kosovë të forcave ushtarake, policore dhe paramilitare të Federatës dhe të Republikës, përveç siç është paraparë në pikën 6 të aneksit 2;

b) Demilitarizimin e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) dhe të grupeve të tjera të armatosura të shqiptarëve të Kosovës siç kërkohet në paragrafin 15 më poshtë;

c) Krijimin e një ambienti të sigurisë në të cilin refugjatët dhe personat e zhvendosur mund të kthehen të sigurt në shtëpitë e tyre, ku mund të funksionojë prania civile ndërkombëtare, ku mund të krijohet një administratë kalimtare, dhe ku mund të shpërndahen ndihmat humanitare;

d) Garantimin e sigurisë dhe të rendit publik derisa prania civile ndërkombëtare të mund ta marrë përgjegjësinë për këtë detyrë;

e) Mbikëqyrjen e procesit të çminimit derisa prania civile ndërkombëtare të mund ta marrë përgjegjësinë për këtë detyrë;

f) Përkrahjen, si të shihet e përshtatshme, dhe bashkëpunimin e ngushtë me punën e pranisë civile ndërkombëtare;

g) Kryerjen e detyrave vëzhguese në kufi siç kërkohet;

h) Sigurimin e mbrojtjes dhe të lirisë së lëvizjes për vete, praninë civile ndërkombëtare dhe për organizatat e tjera ndërkombëtare;

Rezoluta 1244 nuk e njeh zgjedhjen e statusit të Kosovës si pavarësim të plotë por këtë status e njeh vetëm si një autonomi përmbajtjesore të kuadër të RFJ-së nën mbikëqyrjen e OKB-së por që lejon dhe mbikëqyrë zhvillimin e institucioneve të përkohshme demokratike vetëqeverisëse për të siguruar kushte për një jetë normale dhe të qetë për të gjithë banorët e Kosovës;

Po ashtu në bazë të kësaj rezolute Sekretari i përgjithshëm I OKB-së vendos që përgjegjësitë kryesore të pranisë civile ndërkombëtare të përfshijnë:

a) Përkrahjen për krijimin e një autonomie dhe vetëqeverisjeje përmbajtjesore në Kosovë deri në zgjidhjen përfundimtare, duke marrë tërësisht parasysh aneksin 2 dhe marrëveshjet e Rambujesë (S/1999/648);

b) Kryerjen e funksioneve themelore civile administrative aty ku ka nevojë dhe për aq kohë sa kërkohet;

c) Organizimin dhe mbikëqyrjen e zhvillimit të institucioneve të përkohshme për vetëqeverisje demokratike dhe autonome deri në zgjidhjen politike, duke përfshirë këtu edhe mbajtjen e zgjedhjeve;

d) Bartjen e përgjegjësisë të veta administrative institucioneve që do të themelohen, duke mbikëqyrur dhe përkrahur konsolidimin e institucioneve të përkohshme lokale të Kosovës dhe të aktiviteteve të tjera për ndërtimin e paqes;

e) Të ndihmohet një proces politik me qëllim të përcaktimit të statusit të ardhshëm të Kosovës, duke marrë parasysh marrëveshjet e Rambujesë (S/1999/648);

f) Në një fazë përfundimtare, mbikëqyrjen e kalimit të pushtetit nga institucionet e përkohshme të Kosovës tek institucionet e themeluara me marrëveshje politike;

g) Përkrahjen për rindërtimin e infrastrukturës kyçe dhe për rindërtimin tjetër ekonomik;

h) Përkrahjen, në bashkëpunim me organizatat ndërkombëtare humanitare, për ndihmën humanitare dhe ndihmën në raste të fatkeqësive;

i) Ruajtjen e ligjit dhe të rendit, përfshirë këtu themelimin e forcave policore lokale, dhe ndërkohë përmes vendosjes së personelit policor ndërkombëtar që të shërbejë në Kosovë;

j) Mbrojtjen dhe përparimin e të drejtave të njeriut;

k) Garantimin e kthimit të shpejtë dhe të papenguar të gjithë refugjatëve dhe personave të zhvendosur në shtëpitë e tyre në Kosovë;

Një theks i veçantë i kësaj rezolute është ndihma humanitare që kërkon nga RFJ-ja të lejoj hyrjen e ndihmave humanitare dhe aktiviteteve humanitare në mënyrë të pa penguar në Kosovë si dhe të ndihmohet dhe lehtësohet shpërndarja e ndihmave humanitare në Kosovë.

Rezoluta 1244 në vetvete përmbante edhe dy anekse shtesë të cilat kishin të bënin me kushtet e zhvillimit të jetës në periudhën e pasluftës në Kosovë siç janë të paraqitura si në vijim:

Aneksi I

Deklaratë e Kryetarit mbi përfundimin e mbledhjes së ministrave të punëve të jashtme të Grupit G-8 të mbajtur në Qendrën Petersburg më 6 maj 1999

Ministrat e punëve të jashtme të grupit G-8 miratuan parimet e përgjithshme vijuese për zgjidhjen politike të krizës së Kosovës:

- *Ndalja e menjëhershme dhe e verifikueshme e dhunës dhe represionit në Kosovë;*
- *Tërheqja e forcave ushtarake, policore dhe paramilitare nga Kosova;*
- *Vendosja në Kosovë e një pranie efektive civile ndërkombëtare dhe të sigurisë, e mbështetur dhe e miratuar nga Kombet e Bashkuara, e aftë për të garantuar arritjen e qëllimeve të përbashkëta;*
- *Krijimi i një administrate të përkohshme për Kosovën që do të vendoset nga Këshilli i Sigurimit i Kombeve të Bashkuara për të siguruar kushte për një jetë në paqe dhe normale për të gjithë banorët në Kosovë;*
- *Kthimi i sigurt dhe i lirë i të gjithë refugjatëve dhe personave të zhvendosur dhe ardhja e papenguar në Kosovë e organizatave për ndihma humanitare;*
- *Një proces politik drejt krijimit të një marrëveshjeje të përkohshme politike që mundëson për një vetëqeverisje përmbajtësore për Kosovën, duke marrë në tërësi parasysh marrëveshjet e Rambujesë dhe parimet e sovranitetit dhe të tërësisë territoriale të RFJ-së dhe të vendeve të tjera në rajon, si dhe demilitarizimin e UÇK-së;*
- *Qasje të gjithanshme zhvillimit ekonomik dhe stabilizimit të rajonit të përfshirë nga kriza.*

Aneksi 2

Marrëveshja duhet të arrihet në bazë të parimeve të mëposhtme për të shkuar drejt zgjidhjes së krizës së Kosovës:

- 1. Ndalja e menjëhershme dhe e verifikueshme e dhunës dhe represionit në Kosovë.*
- 2. Tërheqja e verifikueshme e të gjitha forcave ushtarake, policore dhe paramilitare nga Kosova sipas një orari të shpejtë.*
- 3. Vendosja në Kosovë e një pranie efektive civile ndërkombëtare dhe të sigurisë nën mbikëqyrjen e Kombeve të Bashkuara, që do të veprojë sipas kapitullit VII të Kartës së KB-ve, e aftë për të garantuar arritjen e qëllimeve të përbashkëta.*
- 4. Prania ndërkombëtare e sigurisë, e cila do të ketë pjesëmarrje të konsiderueshme të forcave të NATO-së, duhet të vendoset nën një komandë dhe kontroll unik dhe të autorizohet për ta krijuar një ambient të sigurt për të gjithë njerëzit në Kosovë, si dhe ta lehtësojë kthimin e sigurt të të gjithë refugjatëve dhe të personave të zhvendosur në shtëpitë e tyre.*
- 5. Krijimi i një administrate të përkohshme për Kosovën si pjesë e një pranie civile ndërkombëtare, nën të cilën populli i Kosovës mund të gëzojë autonomi përmbajtësore në kuadër të RFJ-së, do të vendoset nga Këshilli i Sigurimit i Kombeve të Bashkuara. Administrata e përkohshme duhet të sigurojë administrimin kalimtar gjersa krijon dhe mbikëqyrë zhvillimin e institucioneve përkohshme demokratike vetëqeverisëse për të siguruar kushte për një jetë të qetë dhe normale për të gjithë banorët e Kosovës.*
- 6. Pas tërheqjes, një numri të caktuar të personelit serb dhe jugosllav do t'i lejohet kthimi në Kosovë për t'i kryer funksionet e mëposhtme:*
 - Ndërlidhja me misionin civil ndërkombëtar dhe me praninë ndërkombëtare të sigurisë;*
 - Shënjimi/pastrimi i fushave të minuara;*
 - Mbajtja e një pranie pranë objekteve të trashëgimisë serbe;*
 - Mbajtja e një pranie në vendkalimet kryesore kufitare.*

7. Kthimi i lirë dhe i sigurt i të gjithë refugjatëve dhe i personave të zhvendosur, nën mbikëqyrjen e Zyrës së Komisarit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për Refugjatë (UNHCR) dhe ardhja e papenguar në Kosovë e organizatave për ndihmë humanitare.

8. Një proces politik drejt krijimit të një marrëveshjeje të përkohshme politike që mundëson vetëqeverisje përmbytësore për Kosovën, duke marrë në tërësi parasysh marrëveshjet e Rambujesë dhe parimet e sovranitetit dhe të tërësisë territoriale të RFJ-së dhe të vendeve të tjera në rajon, si dhe demilitarizimin e UÇK-së. Negociatat ndërmjet palëve për arritjen e një zgjidhjeje nuk do të duhej ta vononin apo pengonin krijimin e institucioneve demokratike vetëqeverisëse.

9. Qasje të gjithanshme zhvillimit ekonomik dhe stabilizimit të rajonit të përfshirë nga kriza. Kjo do të përfshijë zbatimin e një pakti të stabilitetit për Evropën Juglindore me pjesëmarrje të gjerë ndërkombëtare në mënyrë që më tutje të zhvillohen demokracia, përparimi ekonomik, stabiliteti dhe bashkëpunimi rajonal.

10. Pezullimi i aktiviteteve ushtarake do të kërkojë pranimin e parimeve të cekura më lartë përveç marrëveshjes për elemente të tjera të kërkuara, të caktuara më parë, të cilat janë saktësuar në fusnotën e mëposhtme.^[11] Më vonë do të përfundohet me shpejtësi një marrëveshje ushtarake-tekniqe, e cila do t'i përcaktojë, ndër të tjera, modalitetet plotësuese, duke përfshirë rolet dhe funksionet e personelit jugosllav/serb në Kosovë:

Tërheqja

- Procedurat për tërheqje, përfshirë këtu orarin e detajuar dhe në fazë, dhe përcaktimin e zonës neutrale në Serbi përtej së cilës forcat do të tërhiqen;

Personeli që do të kthehet

- Pajisjet lidhur me personelin që do të kthehet;

- Kushtet e përgjithshme të përgjegjësive të tyre funksionale;

- Orari i kthimit të tyre;

- Përcaktimi i zonave gjeografike të veprimit të tyre;

- Përcaktimi i rregullave të marrëdhënieve të tyre me praninë e sigurisë ndërkombëtare dhe misionin civil ndërkombëtar.

Shënime

^{1[1]} Elemente të tjera të kërkuara:

- Një orar i shpejtë dhe preciz për tërheqje, që nënkupton p.sh. 7 ditë për tërheqje të plotë, dhe 48 orë për tërheqje të armëve për mbrojtje kundërajrore në një zonë reciproke të sigurisë prej 25 km;

- Kthimi i personelit për t'i kryer të katër funksionet e specifikuar më lartë do të bëhet nën mbikëqyrjen e pranisë ndërkombëtare të sigurisë dhe numri i tyre do të jetë i kufizuar (qindra, jo mijëra); - Pëzullimi i aktiviteteve ushtarake do të bëhet pas fillimit të verifikueshëm të tërheqjeve;

- Diskutimi dhe arritja e një marrëveshjeje ushtarake-teknike nuk do ta zgjasin kohën e përcaktuar më parë për përfundimin e tërheqjeve.

Në një përmbyllje të gjithë asaj siç u tha edhe më lartë është se rezoluta 1244 e parashihte Kosovën si pjesë e RFJ-së nën statusin e një autonomie të mbikëqyruar, gjë që për kohën ishte status i pa kënaqshëm për palën shqiptarë, të cilët nuk u ndalën asnjëherë së vepruari deri sa shpallën pavarësinë e Kosovës.

2.7. Periudha tranzitore e Kornizës Kushtetuese

Në peridhën tranzitore është paraqitur një kornizë kushtetuese që shprehimisht ishte e limituar nga njëra anë dhe një rrugë drejt transformimit të qeverisjes nga ndërkombëtarët tek pushteti lokal dhe hapje e rrugës për krijimin e Kushtetutës së Kosovës. Korniza kushtetuese ishte një akt i përkohshëm tranzitor ashtu sikurse rezoluta 1244. (*Procesi i hartimit të kushtetutës Paul R Ëilliam's Prezantim Korrik 21, 2006 Fq 2-3*)

Korniza Kushtetuese për vetëqeverisje kishte tri qëllime kryesore:

- Të krijojë bazën juridike për mbajtjen e zgjedhjeve të përgjithshme parlamentare dhe për krijimin e institucioneve legjislative, ekzekutive dhe gjyqësore në nivel të Kosovës.

- Vendosjen e vetëqeverisjes së përkohshme për Kosovën brenda kornizës së përcaktuar me rezolutën 1244 për periudhën kalimtare.
- Përgatitjen e Kosovës për zgjidhjen finale politike, proces ky që lihej për një fazë të mëvonshme, pas përfundimit të administrimit ndërkombëtar, të përcaktuar me rezolutën 1244.

Pas funksionalizimit të kësaj kornize kushtetuese me qëllim të zgjidhjes së statusit final të Kosovës gjatë kësaj periudhe mund të identifikojmë edhe tri nga momentet kyçe me rol të veçantë të njohura si Standardet para statusit, raporti i z. Kai Aide dhe bisedimet e Vjenës nga grupet negociatore (*Arsim Bajrami: Historia e Konstucionalizimit Shqiptar 1912-2012 Fq. 233*).

2.8. Standardet për Kosovën

Dokumenti i njohur si “Standardet para statusit” ishte ndër dokumentet e para i cili injoroi komplet rezolutën 1244 dhe kështu ishte një hap më afër definimit të statusit final të Kosovës. Në këtë dokument paraqiteshin standardet që Kosova duhet të përmbushte për të qenë sa më afër zgjidhjes përfundimtare. Ky dokument u nënshkrua me 10 dhjetor 2003 dhe përmbante 8 standarde (*Dokumenti zyrtar “Standardet për Kosovën” 10 dhjetor 2003*):

1. Funksionalizimi i institucioneve demokratike (Krijimi i institucioneve vetëqeverisëse, mbajtja e zgjedhjeve të lira dhe demokratike, mediat dhe shoqëria civile)
2. Sundimi i ligjit (Forcimi i ligjit në Kosovë, dhe garantimi se të gjithë janë të barabartë para ligjit dhe do të ketë ndëshkim për krimet e ndryshme, ekonomike dhe financiare)
3. Liria e lëvizjes (Garantimi i lirisë së lëvizjes për të gjithë si dhe përdorimit të gjuhës në bazë të nacionalitetit)
4. Kthimi i qëndrueshëm dhe të drejtat e komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre (garantimi i kthimit të sigurt të komuniteteve në vendbanimet e tyre të më hershme)
5. Ekonomia (Krijimi i ambientit për zhvillim të qëndruar ekonomik)
6. Të drejtat pronësore, ku hynë edhe ruajtja e trashëgimisë kulturore (Garantimi i ruajtjes së trashëgimisë kulturore për të gjitha etnitë në Kosovë)
7. Dialogu (Vazhdimi i dialogut në mes të palës Kosovare dhe asaj Serbe)
8. Trupat mbrojtëse të Kosovës (transformimi i sigurt i Trupave Mbrojtëse të Kosovës në një forcë që do të njihej si Forca e Sigurisë së Kosovës)

Në hyrje të këtij dokumenti është një pasues i veçante në të cilin thuhet: *“Një Kosovë ku të gjithë pa marrë parasysh përkatësinë etnike, racën ose fenë janë të lirë të jetojnë, punojnë dhe udhëtojnë pa frikë, ose rreziqe dhe ku ka tolerancë, drejtësi dhe paqe për të gjithë”*.

2.9. Raporti i emisarit të posaçëm të OKB-së z. KAI AIDEN

Dy vite pas aprovimit të standardeve para statusit OKB caktojë një emisar të posaçëm për të bërë vlerësimin e implementimit të këtyre standardeve ai ishte z. Kai Aiden. Vlerësimi i njohur ndryshe si raporti i z. Kai Aiden kishte të bënte me një pasqyrim të përgjithshëm të gjendjes së Kosovës në vija të përgjithshme dhe në mes të tjerave thuhej: *“Në mesin e të gjitha përvojave tona, do të veçoja posaçërisht dhjetë ditët e kaluara duke udhëtuar gjithandej Kosovës, për të takuar sa më shumë njerëz që ka qenë e mundur në qytete, fshatra e vendbanime të panumërta. Ky udhëtim na ka treguar atë që nuk mundeshin takimet në Prishtinë, pra mënyrën se si jetojnë njerëzit në Kosovë, vështirësitë me të cilat përballen dhe shpresat e frika që i kanë për të ardhmen e tyre. (Raporti i situatës në Kosovë - z. Kai Aiden 30 Nentor 2004).*

Ky raport vlerësonte mjaft mirë përmbushjen e standardeve para statusit dhe si i tillë ishte mjaft pozitiv për Kosovën. Një veçori që duhet theksuar tek ky raport ishte dallimi në mes tij dhe dokumentit të standardeve sa i përket referencës në rezolutën 1244 ku z. Kai Aiden thekson: *“Konsideratat dhe rekomandimet e më poshtme paraqesin gjykimin tim më të mirë se ku gjendemi dhe se si do të duhej të vazhdonim në përputhje me Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit”*(Raporti i situatës në Kosovë - z. Kai Aiden 30 Nentor 2004).

2.10. “Grupi i Kontaktit”

Një mekanizëm tjetër i cili u krijua pas vlerësimit të z.Kai Aiden ishte i ashtuquajturit Grupi i Kontaktit të cilët pas vlerësimit të raportit të z. Aiden dolën konkretisht me disa parime të cilat janë dëshmuar mjaftë të rëndësishme për stabilitetin e ardhshëm të Kosovës, jo vetëm si një grup i parimesh por edhe një bazë për shtetin e ardhëm dhe për gjendjen juridike në Kosovë që tashmë

ishite e krijuar. (www.dw.com/sq/grupi-i-kontaktit-statusi-i-kosov%C3%ABs-t%C3%AB-zgjidhet-brenda-vitit-2006/a-2589806)

2.11. Bisedimet e Vjenës

Me 20 shkurt 2006 filloj një proces tjetër dhe mjaft i rëndësishëm për zgjidhjen e statusit final të Kosovës, ky proces ishte i njohur si bisedimet e Vjenës ku Kosova krijoi një grup negociator për bisedime që ishte i përbërë nga pesë lider të njohur të Kosovës të caktuar nga Presidenti i Kosovës, grup ky që më vonë do të njihej si Grupi i Unitetit. Në këto bisedime mori pjesë përfaqësuesi special i OKB-së z. Marti Ahtisaari.

Ndër temat që u biseduan në mes të palës kosovare dhe asaj serbe ishin:

- Decentralizimi
- Mbrojtja e trashëgimisë fetare dhe kulturore në Kosovë
- Mbrojtja e të drejtave të pakicave në Kosovë dhe
- Ekonomia

Grupi i Unitetit mbajti gjithsej 14 takime negociatore për çështjet e lartcekura, të cilat rezultuan si jo të suksesshme pasi që nuk patën ndonjë rezultat të theksuar.

Pas këtyre bisedimeve përfaqësuesi i OKB-së z. Ahtisari kishte nxerrur dokumentin “Propozimi gjithëpërfshirës për zgjidhjen e statusit të Kosovës” që më vonë do të njihej edhe si “Pakoja e Ahtisarit”.

Edhe pse si dokument nuk përmbushte plotësisht pritjet e asnjërës palë, mund të themi se ky ishte dokumenti më themelor para definimit përfundimtar të statusit të Kosovës. (*botapress.info*)

2.12. Pakoja e Ahtisarit

Lirisht mund të themi se “Pakoja e Ahtisarit” ishte një ndër dokumentet bazë udhë rrëfyese për zgjidhjen e statusit politik të Kosovës. Në aspektin e përgjithshëm ishte një dokument kornizë për Kosovën ose një udhërrëfyese për zgjidhjen e statusit të Kosovës. Nga aspekti strukturor ishte një dokument që në vete përmbante 12 shtojca dhe shtojcat shtesë të shtojcës së tretë (*Plani i Ahtisarit Mars 2007*).

- Aneksi i parë kishte të bënte kryesisht me shtetin ligjor në Kosovë, mënyrën e qeverisjes si dhe vet përbërjen e Kushtetutës së Kosovës, po ashtu parashihte edhe shtyllat e pushtetit shtetëror, përbërja e qeverisë, parlamentit, sistemit të drejtësisë, liritë dhe të drejtat e njeriut etj. Po ashtu edhe depozita të tjera të rëndësishme si mënyra e ndryshimit të Kushtetutës, dispozitat kalimtare etj. Ky aneks kërkon që Kushtetuta t'i përmbahet në tërësi pakos, në fillim të aneksit thuhet *"Kushtetuta e Kosovës do të përfshijë, mirëpo nuk do të jetë e kufizuar në parimet dhe elementet në vijim"*.
- Aneksi i dytë *"Të drejtat e komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre"*, përbënë një segment mjaft të ndjeshëm mbi bazën e të cilit është e ndërtuar edhe vetë Pakoja e Ahtisaarit. Në këtë aneks paraqitet pozita e komuniteteve pakicë në Kosovë, garantimi i lirive dhe të drejtave të të gjitha komuniteteve në Kosovë, me theks të veçantë atij serb.
- Aneksi i tretë i jep hapësirë të veçantë decentralizimit, i cili është i përmbledhur në kuadër të aneksit të tretë, ku në detaje pasqyrohet modeli i qeverisjes lokale dhe karakteristikat e tjera të cilat i ngërthen në vete ky lloj i decentralizimit.
- Aneksi i katërt ka të bëjë kryesisht me mënyrën e funksionalizimit të sistemit gjyqësorë;
- Aneksi i pestë ka të bëjë me trashëgiminë fetare dhe kulturore të përgjithshme në vend si dhe me theks të veçantë trashëgimia kulturore e komunitetit serb në Kosovë.
- Aneksi i gjashtë ka të bëjë kryesisht me borxhin ndërkombëtar të Kosovës si pjesë e RFJ-së mënyrat e kthimit obligimet dhe të gjitha procedurat që lidhen me këtë borgj.
- Aneksi i shtat është aneks që ka të bëjë me pjesën pronësore dhe arkivore, në të cilin parashiheshin regjistrat arkivor, kadastral dhe të tjera detaje për funksionalizimin e kësaj sfere të jetës.
- Aneksi i tetë kishte të bënte me sektorin e sigurisë, si një ndër sektorët shumë të rëndësishëm për një shtet të ri i sistemuar në aneksin e tetë, përcakton në vija të trasha dukjen e mekanizmave kyç të kësaj fushe.
- Aneksi i nëntë, dhjetë dhe njëmbëdhjetë parashihte formën e prezencës ndërkombëtare, duke përfshirë atë civile, trupat ndërkombëtare për fushën e drejtësisë si dhe atë ushtarake.
- Aneksi dymbëdhjetë përfshin agjendën legjislative, që në vete ngërthen një mori ligjesh që dalin nga pakoja me qëllim të funksionalizimit sa më të mirë të shtetit të ri të Kosovës.

2.13. Karakteristikat themelore të Pakos së Ahtisaarit

Pas përpjekjeve të mëdha të dy palëve asaj shqiptare dhe serbe për bisedime të vazhdueshme nuk mund të themi që u arrit ndonjë marrëveshje konkrete në mesë palëve për arsye të kërkesave gjithmonë të pa pranueshme nga pala kundërshtarë, si nga aspekti territorial, po ashtu pasuritë shtetërore, pronat, statutet juridike etj. Pakoja e ahtisarit u servua si një dokument dhe një zgjidhje më e mira e mundshme për kohën me qëllim të zgjidhjes së statusit të Kosovës, mirëpo edhe pse i referuar si një marrëveshje realisht nuk ishte një e tillë pasi që palët nuk ishin marruar vesh për këtë zgjidhje, mirëpo edhe si e tillë ky dokument kishte anët pozitive dhe negative për të dyja palët por ishte zgjidhja më e duhur e kohës. Nëse shikojmë anët apo karakteristikat pozitive apo negative nga këndvështrimi i Kosovës janë (*Propozimi gjithëpërfshirës për zgjidhjen e statusit të Kosovës 26 Mars 2007*):

- *Hapja e rrugës për statusin përfundimtar;*
- *Bërjen e Kosovës me Kushtetutë si aktin më të lartë juridik;*
- *Hapjen e rrugës për shfuqizimin e rezolutës 1244 dhe qartësimin e gjendjes e cila ishte krijuar nën administrimin shumëvjeçarë ndër kombëtarë;*
- *Krijimi i mundësisë për krijimin e një force të re të sigurisë, e cila realisht është ushtria e ardhshme e Kosovës;*
- *Sendërtimin i parimeve të grupit të kontaktit.*

Deri këtu mund të shohim këtë dokument nga ana pozitive të cilat janë një hapë drejt krijimit të shtetit të Kosovës, mirëpo mund të themi se ky dokument po ashtu ka elemente për krijimin e shtetësisë së Kosovës si:

- *E drejta për të negociuar marrëveshjen ndërkombëtare;*
- *E drejta për ratifikim të konventave ndërkombëtare;*
- *Marrja e obligimit për borxhin ndërkombëtar;*
- *Pranimi që e gjithë prona publike në Kosovë kalon në pronësi të saj;*
- *Kontrolli i hapësirës ajrore, argumente këto tepër të rëndësishme për një shtet të mirëfilltë.*

Në anën tjetër çështjet e pa definuar mirë apo të mbetura pezull nga kjo pako dhe që mund të paraqesin një anë tjetër nga pikëpamja e Kosovës mund të veçojmë:

- *Mosdefinimi i statusit të Kosovës, meqë në tërësi dokumenti është i paqartë kur është në pyetje definimi i statusit;*
- *Pakoja e Ahtisaarit ofron një pozitë të privilegjuar të pakicave;*
- *Decentralizimi paraqitet mjaft asimetrik dhe i krijuar më shumë në baza etnike sesa qytetare;*
- *Krijimi i zonave të mbrojtura;*
- *Prezenca e theksuar ndërkombëtare, që në njëfarë mënyre e kufizon dhe e cungon sovranitetin e shtetit të ri të Kosovës.*

Nëse tërheqim një paralele në mes të pakos së ahtisarit dhe rezolutës 1244, vërejmë pako e Ahtisarit i ofrohet shumë afër zgjidhjes së statusit të Kosovës si një shtet me pavarësi të mbikëqyrur nga ana ndërkombëtare, për dallim nga ajo që rezoluta 1244 e parashihte Kosovën ende si një pjesë të RFJ-së, dhe lirisht mund të themi që pas përfundimit të luftës në Kosovë rezoluta 1244 mund të ishte një rrezik i theksuar për kthimin në gjendjen e më hershme por që natyrisht nuk pranohej assesit nga pala Kosovare. Pako e Ahtisarit është një hap i shkëputjes një herë e përgjithmonë i Kosovës nga RFJ-ja e dikurshme. Nga ana e politikës kosovare kjo pako shihej nga këndvështrime të ndryshme

2.14. Shpallja e Pavarësisë - Rruga deri më 17 shkurt

Shpallja e Pavarësisë së Kosovës më 17 shkurt 2008 ishte kurorëzim i një rrugëtimi të gjatë e të vështirë për qytetarët e Kosovës. Për vite me radhë, deri në qershor të vitit 1999, qytetarët vuajtën pasojat e spastrimit etnik nga regjimi serb i Slobodan Millosheviqit. Pas përfundimit të luftës dhe vendosjes së trupave ndërkombëtare në Kosovë, në nëntor 2005 nisi zyrtarisht procesi për statusin përfundimtar. Prej 13 qershorit të vitit 1999, kur forcat serbe u detyruan të largoheshin nga Kosova, ky vend administrohej nga misioni i Organizatës së Kombeve të Bashkuara UNMIK dhe institucionet demokratike të Kosovës: Kuvendi, Presidenti dhe Qeveria (12 vjet shtet: Rruga deri te shpallja e Pavarësisë së Kosovës 17 shkurt 2020).

Edhe pse Serbia nuk kishte kontroll mbi Kosovën, në rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit, disa herë përmendej se Kosova është protektorat i OKB-së, por juridikisht pjesë e Republikës Federale të Jugosllavisë. Më 2 shkurt 2007 i dërguari special për statusin e Kosovës, Martti Ahtisaari, dorëzoi propozimin e tij në Prishtinë dhe Beograd, për Pavarësinë e kushtëzuar të Kosovës, hap që çoi drejt krijimit të shtetit të pavarur. Pasi u mbajtën disa raunde bisedimesh, Kosova u shpall e pavarur më 17 shkurt 2008.

Më 22 korrik 2010, Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë konfirmoi përmes vendimit këshillëdhënës se Pavarësia e Kosovës nuk ka shkelur asnjë nen të Ligjit Ndërkombëtar (Adam Tanner, Reed Stevenson, Kosovo independence declaration deemed legal, Reuters 22 Korrik 2010)

3. DEKLARIMI I PROBLEMIT

Dërgimi në Gjykatën Ndërkombëtare të Drejtësisë i statusit të Kosovës për interpretim dhe vlerësimi i GJND-së ishte një ndër arsytet që më ka shtyrë të punoj këtë tem, poashtu një arsye tjetër ishte pako e shumë përfulur e Ahtisarit gjë që më nxiti kureshtjen që të hulumtoj më shumë për këtë pako dhe të bëjë këtë studim.

Fakti që Pavarsia e Kosovës është njohur nga shumë vende dhe organizata ndërkombëtare e dëshmonë më së miri së shpallja e Pavarsisë së Kosovës ishte e drejt dhe konform rregullave dhe normave si dhe standarteve ndërkombëtare.

4. METODOLOGJIA

Për realizimin e këtij punimi kam përdorur metoda dhe teknika të cilat janë të përshtatshme për punimin e një punimi të diplomës, duke bërë hulumtime të ndryshme nga burimet e shumta, si nga burimet e referuara si libra të autorëve të ndryshëm vendor dhe ndërkombëtar, poashtu nga burimet bazë të dokumenteve të cilat janë të përbendura në këtë punim me qëllim të marrjes së informacioneve nga burimi bazë. Materialet të cilat kanë qenë në gjuhën angleze jam munduar të i studioi si të tilla me qëllim që të kuptoj sa më shumë esencën e këtyre dokumenteve.

Për këtë punim përveq burimeve të lartcekura jam referuar poashtu në burime nga interneti, artikuj, buletine, revista dhe publikime të ndryshme zyrtare.

5. PËRFUNDIMET

Proceset në të cilat ka kaluar populli i Kosovës që nga periudhat e më hershme e deri më tani dhe përpjekja e vazhdueshme për liri dhe pavarësi janë faktet më të rëndësishme pse Kosova duhet të ishte shpallur Pavarësi.

Përpjekjet e vazhdueshme ndërkombëtare e shteteve evropiane, SHBA-së dhe shteteve të tjera mike të Kosovës me qëllim zgjidhjen e statutit të Kosovës është fakt mjaft i rëndësishëm për shpalljen e Kosovës shtet të pavarur.

Vendimi i Gjykatës Ndërkombëtare *konfirmoi përmes vendimit këshillëdhënës se Pavarësia e Kosovës nuk ka shkelur asnjë nen të Ligjit Ndërkombëtar është fakti më i rëndësishëm për legjitimitetin e shpalljes së Pavarësisë së Kosovës.*

"Pavarësi është qëllimi. Kjo është ajo çka populli i Kosovës duhet ta dijë" - **George W. Bush**, president i ShBA-ve në Tiranë më 11 Qershor 2007

6. BIBLOGRAFIA DHE REFERNCAT:

- Arsim Bajrami: Historia e Konstucionalizimit Shqiptar 1912-2012.
- Blerim Shala “Vitet e Kosovës 1998-1999”, 2001
- Marrëveshja e Kumanovës 1999
- KCSS, Context Analyzes of SSR in Kosovo,
- Plani i Ahtisarit Mars 2007.
- Propozimi gjithëpërfshirës për zgjidhjen e statusit të Kosovës 26 Mars 2007:
- Procesi i hartimit të kushtetutës Paul R. Eilliam’s Prezantim Korrik 21, 2006
- Dokumenti zyrtar “Standardet për Kosovën” 10 dhjetor 2003:
- S/RES/1244 1999 10 Qershor 1999 - UN Rezoluta e kombeve të bashkuara 1244.
- [Adam Tanner](#), [Reed Stevenson](#), Kosovo independence declaration deemed legal, Reuters 22 Korrik 2010
- core.ac.uk/display/143966928
- Historia e Kosovës nga Mbretëria Dardane deri në dyndjet e popujve Slav
- www.hrw.org
- <https://www.dw.com/sq/bombardimet-q%C3%AB-i-dhan%C3%AB-fund-vuajtjes/a-17517608>
- unmik.unmissions.org/sq/rezoluta-1244-e-kombeve-t%C3%AB-bashkuara
- www.dw.com/sq/grupi-i-kontaktit-statusi-i-kosov%C3%ABs-t%C3%AB-zgjidhet-brenda-vitit-2006/a-2589806
- botapress.info